



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2504 Prot.

Tiranë, më 30 . 4 . 2020

U R D H Ë R

Nr. 104 , datë 30 . 4 . 2020

P Ë R

**MARRJEN E MASAVE PËR MBYLLJEN E VITIT AKADEMIK 2019-2020  
NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR SHKAK TË  
GJËNDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE TË SHKAKUAR NGA  
PANDEMIA E COVID-19**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 18/2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” dhe pikës 6.1 të vendimit nr. 243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave. “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”,

U R D H Ë R O J:

1. Institucionet publike të arsimit të lartë, për mbylljen e vitit akademik 2019-2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkakuar nga pandemia e COVID-19, të marrin masa për:
  - a) prioritizimin e punës për studentët e të gjitha cikleve të studimit që diplomohen në vitin akademik 2019-2020, për kthimin në auditor të studentëve për përsëritjen e leksioneve, seminareve apo punëve laboratorike, brenda muajit qershor të vitit 2020, për një periudhë jo më pak se 3 javë;
  - b) krijimin e mundësive për studentët e të gjitha cikleve të studimit që diplomohen në vitin akademik 2019-2020, për dhënien e provimeve, përfshirë ato të diplomimit, në periudhën 1 korrik – 7 gusht 2020;
  - c) vijimin e mësimdhënies on-line për mbylljen e planeve mësimore në çdo program studimi;
  - d) krijimin e mundësive për kthimin në auditor të studentëve të viteve të para dhe të viteve të ndërmjetme të të gjitha cikleve të studimit, për përsëritjen e leksioneve, seminareve apo punëve laboratorike, pas datës 25 gusht të vitit 2020, për një periudhë jo më pak se 4 javë;

- e) krijimin e mundësive për studentët e viteve të para dhe viteve të ndërmjetme, të të gjitha cikleve të studimit, për dhënien e provimeve dhe përmbylljen e çdo detyrimi të mbetur për vitin akademik 2019-2020, brenda muajit tetor të vitit 2020;
  - f) planifikimin e prezencës së studentëve në institucion, me qëllim minimizimin e numrit të tyre në auditorë, laboratorë, etj., për respektimin e distancimit social, pastrimin dhe higjienizimin e ambienteve;
  - g) miratimin e rregulloreve të brendshme nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë, për sjelljen e studentëve në institucion, hyrje-daljet, mbrojtjen e tyre, distancimin social, lëvizjet në institucion, si dhe higjienizimin dhe dezinfektimin e rregullt të ambienteve, mbi bazën e rregullores së miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe rekomandimeve të Institutit të Shëndetit Publik.
2. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë, të hartojnë dhe paraqesin në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, brenda datës 15 maj të vitit 2020, planin e masave organizative dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij urdhri, në të cilin përfshijnë, numrin e saktë të studentëve që planifikohen të frekuentojnë institucionin, për secilën periudhë, sipërfaqet në dispozicion të shprehur në m<sup>2</sup>, me qëllim garantimin e distancimit social të studentëve dhe stafit akademik, pjesëmarrjen në procesin e mësimdhënies on-line dhe format si është zhvilluar mësimdhënia on-line.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Besa SHAHINI

